



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pml.nr.10/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.K., për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.3 dhe 1.4 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda P.nr.50/2018 të datës 12.06.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.344/2020 të datës 21.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më 3 mars 2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S.K., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda P.nr.50/2018 të datës 12.06.2020 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.344/2020 të datës 21.10.2020.

A r s y e t i m

Vendimi i Gjykatës Themelore

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin P.nr.50/2018 e datës 12.06.2020, të dënuarin S.K. e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasja e

rëndë nga neni 179 par.1 nënpar.1.3 dhe 1.4 të KPRK-së dhe e ka dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 17 (shtatëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 04.01.2018 e tutje. I dënuari është obliguar në pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 50 €, si dhe nga 50 € në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse përfaqësuesi i të dëmtuarës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.344/2020 e datës 21.10.2020, ka refuzuar si të pabazuara ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren dhe mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. N.D. nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe të anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe lëndën ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.9/2021 e datës 19.01.2021, ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e paraqitura në kërkesë

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit, thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, pasi që në arsyetimet e aktgjytimeve vetëm janë bartur përmbajtja e procesverbaleve të shqyrtimeve gjyqësore. Posaçërisht aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë

nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për çështjen kryesore por edhe arsyet e theksuara janë në kundërshtim të plotë me vetveten dhe përmbajtjen e provave, dhe për më tepër, arsyetimi është në kundërshtim të plotë me provat e administruara duke u mjaftuar me thëniet se i besoi apo nuk i besoi provave.

Pretendohet se në këtë çështje penale e paqartë ka mbetur koha e kryerjes së veprës penale përkundër faktit se për këtë janë nxjerrë tri ekspertiza mjeko-ligjore pasi që dy të parat ishin kundërthënëse dhe për këtë arsye me urdhër të gjykatës së shkallës së parë është bërë ekspertiza prej tre ekspertëve të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të cilët janë dëgjuar gjatë seancës gjyqësore. Pra duke u bazuar në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë koha e vdekjes rezulton të jetë me datë 04.06.2013 pas mesnatës rreth orës 03:23-06:47, kurse sipas ekspertizës së tre ekspertëve përkitazi me kohën e vdekjes theksohet se vdekja e të ndjerës kishte ndodhur me besueshmëri të lartë mes 7-9 orë, kurse me besueshmëri të ulët në mes orës 6-10, ashtu që kufijtë e skajshëm kohor të ndodhjes së vdekjes përkatësisht versioni i besueshmërisë së lartë kemi të bëjmë me besueshmëri prej 95%. Gjithashtu e rëndësishme është të theksohet se eksperti mjeko-ligjor M.G. i dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor duke u bazuar në faktin se i njëjti kishte kryer edhe autopsinë e të ndjerës, ka dhënë sqarim të hollësishëm përkitazi me kohën e vdekjes, mirëpo përkundër kësaj gjykata arsyeton se kjo kohë ka mbuluar kohën e vdekjes së përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit dhe me këtë rast nuk i ka falur besim ekspertizës së përpiluar nga ana e tre ekspertëve, përkundër faktit se përjashton prezencën e të dënuarit në vendin e ngjarjes në kohën e kryerjes së veprës penale. Duke u bazuar edhe në provat tjera materiale përkatësisht nga incizimi i CD shihet se dalja e të dënuarit nga banesa dhe kalimi i kufirit janë në përputhje të plotë me ekspertizën mjeko-ligjore të tre ekspertëve pasi që i dënuari rreth orës 06:40 min. ka dal nga banesa, kurse kufirin Kosovë-Shqipëri e ka kaluar rreth orës 07:30. Pra të gjitha këto prova kanë vërtetuar gjendjen në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit dhe jo vetëm këto prova por edhe provat tjera të administruara siç janë provat e marra në vendin e ngjarjes përkatësisht gjurmët papilare të gishtërinjve në asnjë mënyrë nuk vërtetojnë së i dënuari ishte kryerës i kësaj vepre penale.

Më tutje pretendohet se shkeljet nga gjykata e shkallës së parë janë vazhduar edhe nga gjykata e shkallës së dytë pasi që nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore e sidomos

provat materiale të cilat vetëm janë parafrazuar në version të shkurtër, nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe me këtë janë shkelur dispozitat e nenit 401 të KPPK-së. Në këtë rast kemi një aktakuzë dhe vendim gjyqësor të bazuar vetëm në supozime dhe paragjykime duke u referuar vetëm në rrethanat se: familja e viktimës nuk e ka varrosur viktimën, i dënuari natën kritike ka qenë në banesën ku është gjetur e vrarë e ndjera dhe se i dënuari po atë dite ka udhëtuar për në Angli dhe të cilat janë indikacione dhe nuk mund të quhen prova se i dënuari është kryerës i veprës penale.

Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit, është i pabazuar, ngase aktgjykimet kundër të cilave ka parashtruar kërkesë, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet konkrete të theksuara në kërkesë përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me dispozitën e nenit 384 par.1 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, rezultojnë të jenë të pabazuara, pasi që me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të qarta dhe të plota përkitazi me çdo pikë të aktgjykimin dhe arsyetimi është në harmoni të plotë edhe me provat e administruara. Posaçërisht është arsyetuar secila provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur me njëra tjetrën si në aspektin e veprimeve të të dënuarit në mënyrë kontinuele nga ardhja e tij në Prizren, kryerja e veprës penale, largimi i tij nga Prizreni dhe duke vazhduar me largimin e tij nga Shqipëria për në Britani të Madhe, dhe për më tepër, këto fakte janë ndërlidhur dhe vërtetuar përmes provave materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë është përqendruar në mbrojtjen e të dënuarit dhe përmes kësaj ka vlerësuar të gjitha provat e

administruara dhe në këtë mënyrë ka bërë krahasime të veprimeve të të dënuarit në raport me provat tjera materiale dhe në raport me dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar. Nga kjo del se nuk qëndron pretendimi i paraqitur në kërkesë, se gjykata e shkallës së parë, dëshmitë e dëshmitarëve vetëm i ka përshkruar, duke u mjaftuar me thëniet se u besoi apo nuk i besoi provave. Gjetjet e gjykatës së shkallës së parë i aprovon edhe kjo gjykatë pasi që bazuar në administrimin e provave, me të drejtë ka ardhur në përfundim se është vërtetuar se i dënuari e ka kryer këtë veprë penale edhe pse kemi të bëjmë me një rast më specifik pasi që në momentin e vrasjes nuk kishte dëshmitar okular, që kishte parë vrasjen. Por e gjithë ngjarja është vërtetuar përmes provave rrethanore e që gjykata e shkallës së parë, këto prova i ka ndërlidhur njëhën me tjetrën dhe ka përjashtuar tërësisht mundësinë e personave tjerë të jenë kryerës të kësaj veprë penale dhe ka ardhur në përfundim se i dënuari është kryerësi i kësaj veprë penale.

Ky përfundim i gjykatës së shkallës së parë bazohet mes tjerash:

- në sjelljet e të dënuarit para kryerjes së veprës penale duke filluar nga ardhja për vizitë tek motra e tij që ishte vizitë e befasishme edhe për vetë të ndjerën, duke u referuar në dëshminë e dëshmitarit L.S., siç është konstatuar në faqen e nëntë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë;

- duke vazhduar me faktin e largimit të tyre nga banesa në orët e hershme të mëngjesit diku pak pas orës 06 pasi kishin kaluar natën së bashku me tani të ndjerën dhe shokun e tij S.H. (i cili gjendet në arrati), duke u referuar raportit të thirrjeve telefonike dhe hartografisë përkatësisht kontaktit telefonik të zhvilluar mes të dëshmitarit I.K. dhe numrit të telefonit që kishte në posedim i dënuari (përshkrimi i arsytimit të aktgjykimit të shkallës së parë faqe 10) dhe gjithashtu duke u referuar në dëshminë e dëshmitarit I.K. “se në mëngjes para orës 07 e kanë thirrur personat për ti marrë me veturën e tij dhe pastaj për ti dërguar për në Shqipëri”

- dhe pastaj kthimin me taksi në Shkodër dhe vazhdimin e udhëtimit të tyre për në Aeroportin e P. për në L. (duke u referuar në raportin informues nga Policia e Republikës së Malit të Zi) dhe për të përfunduar udhëtimi i tij ilegal për në L.

Nga këto del se të gjitha provat e administruara arrijnë në një përfundim se i dënuari ishte kryerësi i veprës penale dhe të cilin konkludim të gjykatës së shkallës së parë e aprovon në tërësi

edhe gjykata e shkallës së dytë dhe e cila në mënyrë të argumentuar dhe të qartë ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar posaçërisht pretendimet përkitazi me konkludimet e ekspertizave mjeko-ligjore dhe në këtë drejtim gjeti se, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të hollësishme ka vlerësuar që të tri ekspertizat mjeko-ligjore madje ka bërë dëgjimin e ekspertëve në seancat gjyqësore.

Duhet theksuar faktin se fillimisht është përpiluar akt ekspertimi mjeko ligjor nga Dr. M.G. i datës 05.06.2013, i cili kishte bërë autopsinë e trupit të të ndjerës dhe i cili ishte dëgjuar gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 26.03.2019 dhe kishte potencuar se koha e vdekjes ishte në periudhën kohore 12-13 orë para shkuarjes së njësisë hetuese të IML në vendin e ngjarjes (hetuesit kishin arritur në vendin e ngjarjes rreth orës 16:40). Edhe përmes ekspertizës së plotësuar mjeko-ligjore e përpiluar nga Dr.V.H. është theksuar koha e vdekjes së të ndjerës dhe me këtë rast ishte konstatuar se: *“...vdekja e të ndjerës I.K. ishte jo më pak se 12 orë nga momenti i ekzaminimit të hetuesit mjekësor...”* dhe i cili konstatim ishte konfirmuar edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 08.07.2019. Megjithatë, për të përcaktuar kohën e vdekjes së viktimës, gjykata e shkallës së parë kishte caktuar grupin e ekspertëve të mjekësisë ligjore të cilët kishin përpiluar ekspertizën dhe të cilat konkluzione i kishin mbështetur edhe gjatë dëgjimit të tyre në shqyrtimin gjyqësor duke potencuar se koha e vdekjes së të ndjerës *“...kishte ndodhur me besueshmëri të lartë mes 7-9 orë, kurse me besueshmëri të ulët në mes orës 6-10 orë ashtu që kufijtë e skajshëm kohor të ndodhjes së vdekjes...”* (duke llogaritur me kohën e arritjes së hetuesve në vendin e ngjarjes rreth orës 16:40). Megjithatë, ekipi i ekspertëve në konkluzionin e tyre kishin paraqitur një varg lëshimesh që janë vërejtur gjatë punës së hetuesve të IML dhe të cilat lëshime kanë ndikuar edhe në përcaktimin e saktësisë së kohës së vdekjes së tani të ndjerës.

Duhet potencuar posaçërisht faktin se mund të konkludohet se gjykata e shkallës së parë ka paraqitur arsyetim të hollësishëm për faktin se i besoi ekspertizës së ekspertit M.G. dhe atë për faktin se i njëjti ishte personi i cili kishte pasur mundësinë që vet të i sheh dhe konstaton shenjat kufomore dhe për këtë arsye ekspertiza e tij ishte çmuar si më e besueshme në relacion me ekspertizën e tre ekspertëve. Në këtë kontest pa dyshim duhet theksuar edhe faktin se të gjitha

ekspertizat e përpilura kanë një konstatim të përbashkët se koha e vdekjes së personit e përcaktuara në bazë të shenjave kufomore është proces mjaft i vështirë dhe i varur nga një mori faktorësh me ndikim siç janë theksuar: “...*shtangësia kufomore, njollat kufomore, temperatura trupore, tharja kufomore dhe faktorët e tjerë plotësuese siç janë kushtet ambientale...*” (konstatim nga ekspertiza e ekspertit Dr. V.H.). Në mënyrë të ngjajshme është përshkruar edhe nga ekspertiza e tre ekspertëve: “...*se përcaktimi i kohës së vdekjes është një detyrë komplekse dhe janë disa faktorë që shpejtojnë apo ngadalësojnë procesin në bazë të cilit përcaktohet koha e vdekjes siç janë mbipësha, plagët e hapura-gjakderdhja masive dhe e shpejtë...*” (konstatim nga ekspertiza e ekspertëve Dr. A.G., Prof.Dr.N.H. dhe Dr.B.C.).

Megjithatë, në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me kohën e vdekjes së të ndjerës, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës është dhënë arsyetim i mjaftueshëm duke marrë për bazë ekspertizat mjeko-ligjore dhe duke i ndërlidhur edhe me provat tjera të administruara rrjedh se koha e kryerjes së veprës penale është në përputhje të plotë me dispozitivin e aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, duke pasur parasysh fakin se edhe ekspertiza e përpiluar nga ana e tre ekspertëve dhe limitet e përcaktuara nga ana e tyre në asnjë rrethanë nuk e përjashtojnë mundësinë që kryerësi të jetë i dënuari për faktin se të gjithë ekspertët qartazi kanë theksuar faktin se përcaktimi i saktë i kohës së vdekjes është një proces mjaft i vështirë dhe i varur nga shumë faktorë.

Sa i përket pretendimeve të theksuara në kërkesë se në rastin konkret kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor i bazuar në supozime dhe paragjykime, duhet theksuar faktin se gjykata e shkallës së parë në mënyrë kronologjike ka arsyetuar aktgjykimin e saj duke dhënë arsye për secilën provë të administruar dhe në kontest të sqarimit zingjiror të rastit të ndodhur. Pa dyshim se rasti konkret bazohet në prova rrethore, mirëpo duke vështuar në kontest të ngjarjes arrihet vetëm në një konkludim se kryerës i kësaj veprë penale kanë qenë i dënuari S.K. dhe S.H. (i cili gjendet në arrati) dhe natyrisht se rrethanat e theksuara në kërkesë se: familja e viktimës nuk e ka varrosur viktimën në vendin e lindjes së saj, i dënuari natën kritike ka qenë në banesën ku është gjetur e vrarë e ndjera dhe se i dënuari ka udhëtuar për në Angli paraqesin indikacione. Mirëpo duhet theksuar faktin se të gjitha këto rrethana të cekura ndërlidhen me tërësinë e ngjarjes, duke filluar nga mënyra e jetesës së mëparshme të së ndjerës e cila fillimisht ishte e martuar dhe pastaj

e divorcuar nga bashkëshorti i saj, fakti se për disa vite kishte jetuar dhe punuar në G., për të vazhduar nga viti 1999 me jetën dhe punën e saj në Kosovë. Dhe të gjitha këto duke u trajtuar në lidhmëri me veprimet e të dënuarit dhe atë që nga momenti i ardhjes së befasishme dhe pa paralajmërim të tij në Prizren, pastaj ikja e tij të nesërmen në orët e hershme të mëngjesit dhe vazhdimi i udhëtimit të tij në relacionin P.-L. dhe për L., pa dyshim se paraqesin prova rrethore të cilat në tërësinë e tyre e bëjnë të besueshëm se kryerës i kësaj vepre penale është i dënuari dhe padyshim se në këtë kontest nuk mund absolutisht të anashkalohej raportet mes të ndjerës dhe familjes së saj dhe mllefinit të tyre të shprehur edhe pas vdekjes së saj duke mos e varrosur në vendin e saj për shkak të së kaluarës së saj.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.10/2021, më 3 mars 2021

B.profesional,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Nesrin Lushta